



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 24.05.2022, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 19.05.2022.
2. Mbi licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1” me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW.
3. Mbi njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike nr. ZRRE/LI\_55/16, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin v\_968\_2018, datë 13.04.2018, për subjektin “Future Energy Trading And Exchange Dynamics sh.p.k.”, që ka regjistruar në shqipëri subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k.; dega në Tiranë”.
4. Mbi njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike nr. ZRRE/LI\_72/21, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin v\_1400\_2021, datë 02.09.2021, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k. (FUENTE Dynamics)”, që ka regjistruar në shqipëri subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k.; dega në Tiranë”.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për transferimin e aseteve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a..
6. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gostima 1” me kapacitet të instaluar 3047 kW, “Gostima 2” me kapacitet të instaluar 5586 kW, “Gostima 3” me kapacitet të instaluar 5335 kW, “Gostima 4” me kapacitet të instaluar 7396 kW, “Gostima 5” me kapacitet të instaluar 10321 kW, “Gostima 5/1” me kapacitet të instaluar 450 kW dhe “Gostima 6” me kapacitet të instaluar 16819 kW, me kapacitet total të instaluar 48 864 kW.
7. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
8. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Kurum International” sh.a., me nr. 372, seria F12/17 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.07.2012, i ndryshuar.